

## LIGJI NR. 06/L -088

### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-042 PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

#### Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

### LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-042 PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

#### Neni 1

1. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.8, fshihet.
2. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.13, riformulohet me tekstin si në vijim:
  - 1.13. **Ofrues i shërbimeve** - çdo person juridik i regjistruar që ka aktivitetet primar, ofrimin e shërbimeve të ujit;
3. Neni 3 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.33, riformulohet me tekstin si në vijim:
  - 1.33. **Zona e shërbimit** - zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

#### Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, nënparagrafi 3.5, fshihet.
2. Në nenin 4 të ligjit bazik, pas nënparagrafit 3.7 shtohet nënparagrafi i ri 3.8, me përmbajtjen si në vijim:
  - 3.8. shqyrton dhe vendos për ankesat e konsumatorëve të paraqitura kundër vendimeve të ofruesit të shërbimeve.

#### Neni 3

1. Neni 17 i ligjit bazik, nënparagrafi 2.3, riformulohet me tekstin si në vijim:
  - 2.3. pranon përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve përmes marrëveshjes për shërbime me komunat në tërë zonën e shërbimit të ofruesit e shërbimit, të përcaktuara me akt nënligjor, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Në nenin 17 të ligjit bazik, pas nënparagrafit 2.5, shtohet nënparagrafi i ri 2.6, me tekstin si në vijim:
  - 2.6. siguron cilësinë e ujit të pijshëm në pajtim me standardet e shërbimeve të përcaktuara nga autoriteti kompetent për shëndetësi publike.

#### Neni 4

1. Në nenin 20 paragrafi 2 dhe 4 si dhe në nenin 21 paragrafi 5 të ligjit bazik, fshihet teksti “**pas konsultimit me Komisionin Këshillues të Konsumatorëve**”.

2. Në nenin 20 të ligjit bazik, paragrafi 5, riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Objektet përcjellëse administrative, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercial-industrialë.

#### Neni 5

Neni 26 i ligjit bazik, fshihet.

#### Neni 6

1. Në nenin 34 të ligjit bazik, titulli “**Ankesat e drejtuara komisionit këshillues të konsumatorëve**” riformulohet me tekstin si në vijim: “**Ankesat e drejtuara Autoritetit**”.

2. Neni 34, paragrafi 2 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Nëse konsumatori i cili ka parashtruar ankesë ofruesit të shërbimeve në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, nuk beson që ankesa e tij është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga ofruesi i shërbimeve brenda një muaji kalendarik nga data kur kjo ankesë ka arritur tek ofruesi i shërbimeve, atëherë ai mund t’ia referojë ankesën me shkrim Autoritetit për shqyrtim.

3. Në nenin 34 të ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Autoriteti nxjerr rregullore për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve që parashtrohen kundër ofruesve të shërbimeve, në lidhje me shërbimet e ofruara. Procedurat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve duhet të jenë transparente dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

#### Neni 7

Pas nenit 35 të ligjit bazik shtohen nenet 35/A dhe 35/B, me tekstin si në vijim:

##### Neni 35/A

##### **Investimet në sektorin e shërbimeve ujore**

1. Investimet në sektorin e shërbimeve të ujit do të bëhen drejtpërdrejt përmes ofruesve të shërbimeve të ujit apo Ministrisë përgjegjëse për ndërmarrjet publike.

2. Në rastet kur komunat vendosin që të financojnë projekte të shërbimeve të ujit, mjetet përkatëse të cilat i alokojnë komunat në dobi të këtyre projekteve konsiderohen donacion për ofruesin e shërbimeve ujore dhe asetet barten tek ofruesi i shërbimeve të ujit.

##### Neni 35/B

##### **Pronësia dhe asetet për ofrimin e shërbimeve të ujit**

1. Për pronat e paluajtshme në të cilat janë ndërtuar objektet e sistemeve të shërbimeve të ujit apo pronat e paluajtshme të cilat janë përcaktuar si zona e parë e mbrojtjes së një burimi i cili shfrytëzohet për shërbimet e ujit e të cilat nuk janë në pronësi të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit, që menaxhon ato sisteme në bazë të licencës së lëshuar nga Autoriteti, Ofruesi i Shërbimeve duhet të ketë të drejtën e shfrytëzimit, në bazë të kontratës me pronarin e ligjshëm të pronës së

paluajtshme ose të ketë të drejtën e pronësisë ose të shfrytëzimit në bazë të shpronësimit sipas ligjit përkatës për shpronësimin.

2. Ofruesi i shërbimeve ka për detyrë të regjistrojë dhe të mbajë evidencë për të gjitha asetet që i shfrytëzon për nevojat e ofrimit të shërbimeve të ujit.

### Neni 8

Titulli i Kapitullit VIII “**DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ADMINISTRATIVE**” riformulohet me tekstin si në vijim: “**KOMISIONI SHQYRTUES DHE PARALAJMËRIMI**”

### Neni 9

Neni 39 i ligjit bazik, fshihet.

### Neni 10

Neni 40 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Nëse Autoriteti, pas kryerjes së hetimeve të arsyeshme, vie në përfundim se ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës ka bërë shkelje sipas nenit 46B të këtij ligji, ose që licenca për shërbim duhet t'i merret për arsyt e parapara në paragrafin 4. të nenit 17 të këtij ligji, dërgon një paralajmërim për ofruesin e shërbimit:

1.1. lidhur me karakterin e shkeljes të cilën ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës besohet ta ketë bërë, dëshmitë që mbështesin mendimin se një shkelje e tillë është bërë, gjobën administrative dhe pasojat e mundshme të shkeljes së tillë;

1.2. lidhur me arsyt se përse Autoriteti beson që licenca për shërbime duhet të merret dhe rrethanat të cilat justifikojnë marrjen e tillë, nëse nuk evitohen brenda periudhës së specifikuar nga Autoriteti në paralajmërimin me shkrim;

1.3. që Autoriteti mund të gjobisë ofruesin e shërbimeve, personin përgjegjës apo, nëse është e rëndësishme, t'ia merr licencën e shërbimit nëse rrethanat që kanë ndikuar në shkelje, ose të cilat justifikojnë marrjen e licencës për shërbime nuk evitohen brenda kohëzgjatjes së paralajmërimit, dhe

1.4. që ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës ka afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune për t'i parashtruar një deklaratë me shkrim Autoritetit përkitazi, me çdo çështje të cilat dëshiron të merren parasysh në mbrojtje të tij, siç janë faktet që zbusin përgjegjësinë e tij dhe ndonjë dëshmi tjetër të rëndësishme.

2. Në fund të kohëzgjatjes së paralajmërimit, Autoriteti lëshon vendimin për ofruesin e shërbimeve, personin përgjegjës në të cilin ceket si në vijim:

2.1. nëse është bërë shkelja, dhe a ekzistojnë rrethanat që kanë sjell deri te shkelja, dhe a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti;

2.2. rrethanat që justifikojnë marrjen e licencës për shërbime a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti;

2.3. se rrethanat që kanë sjell shkeljen ose justifikimin e marrjes së licencës për shërbime nuk janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti:

2.3.1. shumën e cilës do gjobë administrative dhe afatin e pagesës;

2.3.2. se licenca për shërbime është revokuar.

2.4. të drejtën e ofruesit të shërbimeve, personit përgjegjës për t'ia parashtruar kundërshtimin brenda tetë (8) dite Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin.

3. Çdo gjobë administrative e shqiptuar ndaj Ofruesit të shërbimeve, personit përgjegjës në pajtim me nenin 46B duhet t'i paguhet Autoritetit:

3.1. pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së lëshimit të vendimit nga Autoriteti, apo

3.2. nëse Ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës i ka parashtruar kërkesën Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin e tillë, ditën kur Komisioni shqyrtues merr vendimin e tij.

4. Kamata sipas shkallës vjetore prej pesë përqind (5%) llogaritet për çdo shumë të papaguar sipas nenit 46/B të këtij ligji dhe i shtohet asaj shume në ditën e parë të secilit muaj.

#### **Neni 11**

Neni 41 i ligjit bazik paragrafi 1 dhe 4 riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës mund t'i parashtrojë kundërshtim Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar çdo vendimi të sjellë nga Autoriteti në pajtim me paragrafin 2 të nenit 40 të këtij ligji, me kusht që kundërshtimi të jetë bërë me shkrim brenda tetë (8) dite nga data e vendimit të Autoritetit. Për t'i ikur dyshimit, urdhëresat tarifore, udhëzimet administrative dhe rregulloret e lëshuara nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj, gjithashtu i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e Komisionit shqyrtues, nëse ofruesi i shërbimit, personi përgjegjës parashtron kundërshtim për një shqyrtim të tillë.

4. Pas shqyrtimit të prezantimeve të ofruesit të shërbimeve dhe të Autoritetit, komisioni shqyrtues i jep ofruesit të shërbimeve, personit përgjegjës dhe Autoritetit një vendim të hollësishëm me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve.

#### **Neni 12**

Neni 46 i ligjit bazik, fshihet.

#### **Neni 13**

Pas nenit 46 të ligjit bazik, shtohet kapitulli i ri VIII A, me tekstin si në vijim:

### **KAPITULLI VIII/A KUNDËRVAJTJET**

#### **Neni 46/A**

#### **Dispozita të përgjithshme për kundërvajtjet**

Ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës i ofruesit të shërbimeve dënohen për kundërvajtje në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje, përveç nëse me këtë ligj përcaktohet ndryshe.

#### **Neni 46/B**

#### **Kundërvajtjet e ofruesit të shërbimeve**

1. Ofruesi i shërbimeve, në cilësinë e personit juridik, dënohet për kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, nëse kundërvajtja është kryer nga një veprim ose mosveprim i ofruesit të shërbimeve ose të personit përgjegjës të personit juridik, ose nga akti i lejit të një

personi tjetër, i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të ofruesit të shërbimeve brenda autorizimeve të tij, në mënyrë që të përfitojë për ofruesin e shërbimeve ose personin e tretë.

2. Ofruesi i shërbimeve dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) euro, deri në njëzetmijë (20.000) euro, nëse me dashje ose nga pakujdesia, në kundërshtim me:

2.1. nenin 15, paragrafi 1, të këtij ligji ofron shërbime pa pasur licencë përkatëse për shërbime;

2.2. nenin 17, paragrafi 2, të këtij ligji ofron informacione të rrejshme ose të falsifikuara për qëllim të lëshimit të licencës për shërbime;

2.3. nenin 17, paragrafi 3, të këtij ligji nuk i përmbahet kushteve të licencës së shërbimit dhe nuk ka lidhur marrëveshje me autoritetin për ndryshimin, plotësimin ose zëvendësimin e tyre;

2.4. nenin 24, paragrafi 1, të këtij ligji nuk lidhë kontratë për shërbime me secilin konsumatorë ose nëse kontrata për shërbime e lidhur me konsumatorin nuk i përcakton kushtet e përgjithshme, sipas të cilave do t'u ofrohen shërbime konsumatorëve;

2.5. nenin 25 të këtij ligji nuk e krijon dhe mirëmban listën e konsumatorëve, të cilët kanë lidhur kontratë për shërbime;

2.6. nenin 27, paragrafi 2, të këtij ligji, në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit ndërpret shërbimet në kundërshtim me këtë ligj, kontratën ose rregulloret e nxjerra nga Autoriteti;

2.7. nenin 27, paragrafi 5, të këtij ligji në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të ujësjellësit ndërpret shërbimet, pa i ndërmarrë veprimet dhe masat e arsyeshme të kërkuara me ligj;

2.8. nenin 29, të këtij ligji ndërpret shërbimet pa i respektuar procedurat e ndërprerjes të përcaktuara me ligj;

2.9. nenin 32, paragrafi 6, të këtij ligji konfiskon pajisje për shërbimet e ujësjellësit edhe pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një konfiskim të tillë;

2.10. nenin 34 të këtij ligji nuk i ofron mundësi konsumatorit që të parashtrojë ankesë ose brenda afatit të përcaktuar me ligj nuk i jep përgjigje konsumatorit në ankesën e parashtruar;

2.11. nenin 38 të këtij ligji dhe rregulloret e nxjerra nga Autoriteti kundërshton ose pengon inspektimin nga personat e autorizuar nga Autoriteti.

3. Ofruesi i shërbimeve dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëqind (500) euro deri në dhjetëmijë (10.000) euro, nëse me dashje ose nga pakujdesia, në kundërshtim me:

3.1. nenin 19, paragrafi 1, të këtij ligji faturon një ose më shumë konsumatorë për shërbimet e veta, në kundërshtim me tarifat e shërbimit, të përcaktuara nga Autoriteti në urdhëresën tarifore të shërbimit;

3.2. nenin 19, paragrafi 2, të këtij ligji, në cilësinë e furnizuesit të ujit me shumicë, faturon në kundërshtim me tarifat e ujit me shumicë, të përcaktuara nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj;

3.3. nenin 22, paragrafi 1, të këtij ligji ofron shërbime në kundërshtim me standardet e

shërbimit, që janë të zbatueshme për shërbimet e tij;

3.4. nenin 23, paragrafi 2, të këtij ligji nuk i ofron konsumatorëve kartën e konsumatorëve, sipas rregulloreve të nxjerra nga Autoriteti dhe në pajtim me këtë ligj;

3.5. nenin 24, paragrafi 2, të këtij ligji kontrata për shërbime e lidhur me konsumatorin nuk është e përpiluar në mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti;

3.6. nenin 31, paragrafi 1, të këtij ligji nuk e bën rilidhjen e objektit të konsumatorit brenda afatit të përcaktuar me ligj;

3.7. nenin 36, paragrafi 2, të këtij ligji nuk i dorëzon raportet sipas formatit dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti.

#### **Neni 46/C**

##### **Kundërvajtjet e personit përgjegjës të ofruesit të shërbimeve**

1. Personi përgjegjës i ofruesit të shërbimeve dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind (200) euro, deri në dymijë (2.000) euro për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 46B, paragrafi 2, të këtij ligji, nëse i ka shkaktuar këto kundërvajtje me dashje ose nga pakujdesia.

2. Personi përgjegjës i ofruesit të shërbimeve dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëqind (100) euro deri në njëmijë (1.000) euro për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 46B, paragrafi 3, të këtij ligji, nëse i ka shkaktuar këto kundërvajtje me dashje ose nga pakujdesia.

#### **Neni 46/D**

##### **Evidenca për kundërvajtjen**

Autoriteti mban evidencën për kundërvajtjet sipas nenit 41 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

#### **Neni 46/E**

##### **Kompetenca**

Autoriteti ka kompetencën ekskluzive për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes sipas këtij ligji dhe në pajtim me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

#### **Neni 46/F**

##### **Fillimi i procedurës për kundërvajtje**

1. Autoriteti fillon procedurën e kundërvajtjes sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e të dëmtuarit, të personit zyrtar të autorizuar ose të organit të autorizuar sipas nenit 86 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

2. Në rastet kur i dëmtuari, personi zyrtar i autorizuar ose organi i autorizuar parashtrojnë kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, Autoriteti ndjek procedurën e përcaktuar në nenet 61 dhe 62 të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

#### **Neni 46/G**

##### **Vendimi për kundërvajtje**

1. Autoriteti nxjerr vendimin për kundërvajtje, nëse pas administrimit dhe vlerësimit të provave vërteton se janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit për kundërvajtje.

2. Në vendimin për kundërvajtje caktohet afati për pagesën e gjobës, i cili është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data kur vendimi merr formën e prerë. Autoriteti mund të caktojë që dënimi për

kundërvajtje i shqiptuar me gjobë të paguhet me këste, por me kusht që afati i pagesës të mos jetë më i gjatë se gjashtë muaj.

3. Në rastin e pagesës së gjobës në afatin e përcaktuar në vendimin për kundërvajtje, i dënuari lirohet nga pagesa në lartësi prej pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.

4. Autoriteti e nxjerr vendimin për kundërvajtje në formë, brenda afatit dhe sipas procedurës së përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.

5. Vendimi për kundërvajtje me të cilin shqiptohet gjoba, është dokument përmbarues ndaj të cilit zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

#### **Neni 46/H Kundërshtimet**

1. Personi ndaj të cilit është lëshuar vendimi për kundërvajtje mund të parashtrojë pranë Autoritetit kundërshtimin. Kundërshtimi duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtje. Parashtrimi i kundërshtimit shtyn ekzekutimin e vendimit për kundërvajtje dhe pagesën e gjobës së shqiptuar.

2. Çdo vendim apo veprim i Autoritetit, i cili është marrë në bazë të këtij ligji i nënshtrohet shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara në Ligjin për Procedurën Administrative dhe Ligjin për Konfliktin Administrativ. Procedura e shqyrtimit të kundërshtimeve nga komisioni shqyrtues përcaktohet me procedurat e miratuara nga komisioni shqyrtues.

#### **Neni 14 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L-088  
30 maj 2019**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-128-2019, datë 21.06.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**